

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Emine Kaçiku dhe Gyltene Sylejmani, anëtare, në çështjen juridike të paditëses L. M. nga Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës “Kosova e Re” në Prishtinë, për shkak të dëmshpërblimit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.2103/2013 datë 27.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8 mars 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.2103/2013 datë 27.10.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.275/2011 datë 16.4.2013 është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe është detyruar e paditura, që në emër të dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar në aksidentin e trafikut më datë 3.4.2010, paditëses t’i paguaj si vijon: për dhimbje fizike shumë prej 2.800 €, frikë shumë prej 2.500 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 7,5% shumë prej 3.000 €, për shëmtim të shkallës së mesme shumë prej 2.000 €, në emër të ndihmës së personit të tretë për 20 ditë shumë prej 150 €, në emër të ushqimit të përforcuar për 30 ditë shumë prej 200 €, në emër të rehabilitimit klimatik për 20 ditë shumë prej 400 € dhe në emër të shpenzimeve të shërimin shumë prej 290 €, apo gjithsejtë shumë prej 9.540,90 €, të gjitha me kamatë prej 12% në muaj si për mjetet e afatizuara pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 5.10.2011, si ditë e

paraqitjes së padisë e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 889 €.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.2103/2013 datë 27.10.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë, përveç në pjesën lidhur me kamatën e gjykuar, në të cilën pjesë i njëjti aktgjykim është ndryshuar dhe në shumën e gjykuar është caktuar kamata si për mjetet e deponuara në kursim në bankat vendore, në afat prej 1 viti e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 16.4.2013 si ditë e dhënies së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e gjerë në pagesën definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e lartpërmendura të prishen dhe lënda të kthehet në rivendosje ose që të ndryshohen ashtu që paditëses t'i pranohen në emër të dëmshpërblimit shumat e arsyeshme të cilat për paditësen paraqesin kompensim të drejtë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizionin i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 3.4.2010 rreth orës 21, në rrugën lokale të fshatit Radost, në drejtim të fshatit Xërxe, përballë pompës së derivateve të naftës “Zana Petroll”, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në mes të automjetit të markës “Opel vectra” me targë regjistrimi ..., në të cilën si bashkudhëtare ka qenë edhe paditësja dhe automjetit tjetër të markës “Fiat” me targa ..., i cili ka qarkulluar nga drejtimi i kundërt. Nuk është kontestuese fajësia e të siguarit të paditurës e as përgjegjësia e të paditurës për dëmshpërblim. Sipas ekspertizës mjekësore të dr. Xh. S., ortoped dhe dr. N. M., psikiatër, paditësja në këtë aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndrydhje të kokës dhe të barkut duke shkaktuar lëndim të zorrëve të holla, e të cilat pas operacionit janë qepur dhe shoqëruar gjithashtu me gjakderdhje në mezenter dhe për pasojë paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë me kohëzgjatje dhe intensitet të ndryshëm, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në lartësi prej 17,5%, shëmtim të mesëm trupor për shkak të vragës operatore me gjatësi prej 15 cm e cila është në

pjesën qendrore të barkut nën dhe mbi kërthizë në pozicion të dukshëm gjatë rrezitjes në plazhe, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë për 21 ditë, për ushqim të përforcuar 30 ditë dhe për rehabilitim klimatik 20 ditë.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësi soji, gjykata e shkallës së parë pasi që ka gjetur se baza e kërkesëpadisë është jokontestuese, duke zbatuar kriteret ligjore për caktimin e një dëmshpërblimi të tillë, paditëses i ka gjykuar dëmshpërblimin në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e të paditurës, ashtu që ka ndryshuar vetëm vendimin lidhur me kamatën e gjykuar, ndërsa në pjesën tjetër aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar si të drejtë dhe të ligjshëm, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi si të bazuar një qëndrim të tillë të gjykatave të instancës më të ulët lidhur me pranimin e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që aktgjykimet e goditura në këtë pjesë nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë në kuptim të nenit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me shkelje tjera thelbësore të dispozitave në të cilat e paditura thirret në revizion.

Në revizionin e të paditurës vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato, andaj kjo Gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me këto shkelje thelbësore të dispozitave procedurale.

Po ashtu u vlerësuan edhe pretendimet e përgjithësuara të paditurës siç thuhet në revizionin, se lartësia e gjykuar në emër të dëmshpërblimit është e lartë dhe në kundërshtim me kriteret e kompanive të sigurimit dhe me praktikën gjyqësore. Pretendimet e tilla të revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme i vlerësoi si të pabazuara, jo vetëm se në mënyrë konkrete nuk janë sqaruar arsyet pse është i lartë dëmshpërblimi i gjykuar, por edhe se me rastin e gjykimit të lartësive të lartë përmendura në emër të dëmshpërblimit kontestues, në mënyrë të drejtë është zbatuar dispozita e nenit 200 i

LMD. Me rastin e gjykimit të lartësisë së këtij kompensimi për disa forma të dëmit jomaterial , gjykata në kuptim të nenit 200 par.2 të LMD, duhet të kujdeset lidhur me rëndësinë e së mirës së cenuar dhe për qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, por edhe lidhur me atë që mos të favorizohen tendencat e palës tjetër të cilat nuk janë në lidhmëni me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij. Andaj, duke marrë parasysh kriteret e parapara në këtë dispozitë juridike si dhe shkallën e zhvillimit ekonomik të Kosovës, dhe standardin jetësor të qytetarëve në Kosovë, shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së dytë janë reale, dhe jo në kundërshtim me kriteret e lartpërmendura. Lartësia e dëmshpërblimit të gjykuar nuk është në kundërshtim me synimet shoqërore për të cilat është paraparë një formë e dëmshpërblimit të tillë , kështu që, për nga lartësia një dëmshpërblim i tillë, nuk është në kundërshtim as me kriteret e kompanive të sigurimit për zhdëmtimet në procedurë jashtë gjyqësore të personave të dëmtuar në aksidente komunikacioni, e as me praktikën gjyqësore të gjerë tanishme, andaj një lartësi e tillë e dëmshpërblimit nuk paraqet qëllime fitimprurëse për paditësen, kështu që caktimi i kësaj lartësie të dëmshpërblimit nuk përfshihet me pa ligjshmëri të caktuar.

Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuara kundërshtimet e të paditurës përkitazi me ekspertizën mjekësore që ka të bëjë me dhimbjet fizike dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor, ngase në seancën e shqyrtimit kryesor nuk është propozuar super ekspertizë mjekësore, ndërsa kompensimi për këto forma të dëmit, nga ana e gjykatës së shkallës së parë është caktuar në mënyrë të drejtë.

Për arsyet e dhëna më lartë revizioni i të paditurës u refuzua si i pa bazuar, andaj me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.18/2017, datë 8 mars 2017

Kryetari i kolegjit
Shukri Sylejmani